

KOMUNA E

xhetit

Administrata zvarrit zgjedhjen e përfaqësuesve të 62 fshatrave

Arian Duriqi

LIPJAN, 21 DHJETOR – Ekzekutivi i Lipjanit bashkë me Kuvendin po e zvarrisin zgjedhjen e përfaqësuesve të 62 fshatrave të kësaj komune. Kjo çështje është bërë shkak edhe për reagimin e shoqërisë civile në këtë komunë. OJQ "YAHR" ka shprehur shqetësim lidhur me vonesat janë bërë në këtë plan dhe ka vlerësuar se kjo zvarritje ndikon direkt edhe në përfaqësim interesash të banorëve nëpër vendet rurale. "Kemi shqetësimin tonë si shoqëri civile për vonesat që janë shkaktuar nga ana e legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit në zgjedhjen e përfaqësuesve të 62 fshatrave. Moszgjedhja e këtyre këshillave të fshatrave do të ndikojë direkt edhe në përfaqësimin e interesave të këtyre fshatrave dhe me këtë do të ndikojë edhe në mirëqenien e qytetarëve", ka thënë Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv i OJQ "YAHR". Ai ka shtuar se pas një bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe institucioneve komunale në vitin 2011, ishin zgjedhur mbi 30 këshilla të fshatrave, nëpërmjet zgjedhjeve të organizuara në mënyrë

demokratike, e ku pjesëmarrës në ato zgjedhje ishin edhe partitë politike opozitare, asokohe. Ato këshilla tashmë s'kanë më mandat. "Pas skadimit të mandatit të legjislativit të kaluar në vitin 2013, në mënyrë automatike ka skaduar mandati për përfaqësuesit dhe këshillat e fshatrave. Legjislativi i tanishëm deri në tani me përjashtim të miratimit të një rregulloreje nuk ka marrë ndonjë veprim konkret në zgjedhjen e përfaqësimit të fshatrave", ka deklaruar Krasniqi, ndërkaq, ka shtuar: "Në tetor të këtij vit 2014, është miratuar rregullorja për bashkëpunimin e fshatrave me institucionet komunale me shumë kundërthënie midis partive politike të koalicionit qeverisës, edhe pse rregullorja e tanishme është me një sistem krejt ndryshe nga rregullorja e kaluar". E, Krasniqi krejt në fund po saktëson se Komuna obligohet që të organizojë dhe takime të hapura me qytetarë për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Zyrtarë të Komunës së Lipjanit, ndërkaq, nuk kanë pasur ndonjë deklaram, të entjen, rreth kësaj pune.

© KOHA Ditore

Opozita akuzon pozitën për debate publike formale me qytetarë



vizjes "Vetëvendosje",
kte për ndarjen e
të buxhetit. Sipas tij,
kenderajt me 50.000
marrë për këtë vit
shtetit 11,8 milionë
kapitale, teksa ajo e
0.000 banorë merr
00 euro

kenderajt i ka 50.000
lo të marrë për këtë vit
i shtetit 11,8 milionë
kapitale, ajo e Deçanit
banorë merr vetëm
Komuna e parë do të
ozicion 236 euro për
ndërsa e dyta 11.5
llogaritur ai.

© KOHA Ditore